

“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE
SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

“BILLA&CO” sh.p.k

Autostrada Tirane –Durrës, pranë ish Radiostacionit, Kashar Katund i Ri, Tirane.
Tirana – Albania

Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
(me raportin e audituesit të pavarur ne vazhdim)

Tiranë, 27 Mars 2017



“BILLA&CO” sh.p.k

PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEJE, PËRNDRYSHË SHKRUHET

Përmbajtja

1. Opinioni i Audituesit të pavarur
2. Bilanci Kontabël
3. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
4. Pasqyra e flukseve monetare
5. Pasqyra e ndryshimeve në kapital
6. Shënime

A handwritten signature in blue ink is written over a circular blue stamp. The stamp contains the text "SHUMAT NË LEJE, PËRNDRYSHË SHKRUHET" and the number "0197" at the bottom.

“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e Situatës Financiare e datës 31 Dhjetor 2016

AKTIVET	Shen	31.12.2016	31.12.2015
Aktivitet Afatshkurtra			
Aktive monetare	4	4,106,139	3,213,937
Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	5	128,900,196	87,748,264
Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	6	63,635,232	23,021,005
Instrumente të tjera borxhi	7	3,401,137	1,627,232
Investime të tjera financiare	8	0	26,077,733
Totali		195,936,565	138,474,234
Inventari			
Lëndë të para e materiale të tjera	9	929,700	218,096
Mallra për rishitje	9	695,410,323	546,036,106
Pavapogosat për furnizime	9	11,586,850	22,102,637
Totali		707,926,872	568,356,839
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	10	3,701,524	333,706
Total i Aktivëve Afatshkurtra		911,671,100	710,378,716
Aktivitet afatgjata			
Investimet financiare afatgjata			
Tituj të tjera të huadhenies	11	-	-
Totali		26,077,733	-
Aktive afatgjata materiale		26,077,733	
Toka	12	84,000,000	84,000,000
Ndërtesa	12	84,284,926	89,603,904
Makineri dhe pajisje	12	14,894,975	12,771,185
Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)	12	8,431,681	5,245,662
Aktive afatgjata në proces	12	16,641,321	-
Totali		208,252,903	191,620,752
Totali i aktivëve Afatgjata		234,330,636	191,620,752
TOTALI I AKTIVEVE		1,146,001,736	901,999,468
DETYRIMET DHE KAPITALI			
DETYRIMET Afatshkurtëra			
Huamarrjet			
Huat dhe obligacionet afatshkurtra	13	82,648,503	71,355,718
Huat dhe parapagimet			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	14	237,306,069	128,467,743
Të pagueshme ndaj pimonjësve	15	7,504,205	6,686,012
Detyrime latimore	16	8,420,229	5,249,457
Hua të tjera	17	6,356,000	20,000,000
Pavapagimet e arkëtuara	18	3,742,926	13,001,032
Totali i detyr. afatshkurtra		345,977,932	244,759,963
DETYRIME AFATGJATA			
Hua bankare	19	39,838,701	49,971,282
Qira Financiare	20	8,921,884	4,964,469
Totali i detyr. afatgjata		48,760,586	54,935,751
Totali i detyrimeve		394,738,517	299,695,714
Kapitali			
Kapitali aksionar	21	600,000,000	500,000,000
Rezerva ligjore	21	2,303,754	2,050,584
Fitimet e pashpërdara	21	-	-
Fitimi (lumbja) e vitit financiar	21	148,959,464	100,253,171
Totali i kapitalit (III)		751,263,218	602,303,755
TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT		1,146,001,736	901,999,468



Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-31

“BILLA&CO” sh.p.k

**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUËSE**

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e Performancës për periudhën që përfundon më 31.12.2016

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve

		Viti 2016	Viti 2015
Shitjet neto	22	1.370.482.732	1.038.439.215
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	23	27.165.889	30.997.786
Materialet e konsumuara .	24	-1.070.051.801	-843.329.726
Kosto e punës	25	-	-
-Pagat e personelit	25	-52.773.508	-38.666.120
-Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	25	-5.347.595	-3.576.195
Amortizimi dhe zhvlerësimet	12	-10.919.718	-11.207.361
Shpenzime të tjera	26	-80.851.996	-51.588.139
Totali i shpenzimeve		-1,219,944,618	-948,367,541
Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore		177,704,003	121,069,460

Te Ardhura Te tjera

Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme	27	1.955.832	651.206
Total te Ardhura te tjera		1,955,832	651,206

Shpenzime financiare

Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	28	-7.995.693	-10.051.331
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	29	4.275.485	6.662.019
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare		-	-
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		-3,720,207	-3,389,313
Fitimi (humbja) para tatimit	30	175,939,628	118,331,353
Shpenzimet e tatimit aktual mbi fitimin	30	-26.980.164	-18.078.183
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		148,959,464	100,253,171

Të Ardhura të Tjera gjithëpërfshirëse


Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAM		-	-
Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AA Financiare		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse neto nga tatimet		148,959,464	100,253,171
Totali i të ardhurave neto gjithëpërfshirëse për periudhën		148,959,464	100,253,171

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-31

Pasqyrat Financiare “Billa&Co shpk ” janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë

Më datë 27 Mars 2017

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Erik Kenta Selimaj


Administratori

Jetmir Billa



“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e ndryshimit të flukseve te mjeteve monetare për periudhën që përfundon më
31.12.2016

	Shen	2016	2015
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi pas tatimit	30	<u>148,959,464</u>	<u>100,253,171</u>
<i>Rregullime për:</i>			
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		6.790.164	3.932.512
Amortizimi i Aktive Afatgjata	12	10.919.718	11.207.361
		<u>166,669,345</u>	<u>115,393,044</u>
Rritje/rënie në tepricën e Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	5	-41.151.932	-48.897.351
Rritje/rënie në tepricën e Llogari/Kërkesa të arkëtueshme te tjera	6	-40.614.227	5.433.120
Rritje/rënie në tepricën inventarit	9	-139.570.033	-61.983.461
Rritje/rënie në Te ardhura/Shpenzimet e Shtyra	10	-12.625.925	3.434.112
Rritje/rënie në tepricën e Llogarive te Pagueshme (Furnitorëve)	14	108.838.326	1.616.925
Rritje/Rënie në detyrimet ndaj punonjësve	15	818.193	874.100
Rritje/rënie në tepricën e Detyrimeve tatimore	16	-3.619.392	562.190
Huamarije afatshkurtër - Overdraft	13	11.292.785	-5.121.189
Rritje/rënie në Investime të tjera financiare	7.8	24.303.829	-1.019.421
Rritje/rënie në Hua te tjera	17	-13.644.000	6.293.377
		<u>-105,972,377</u>	<u>-98,807,598</u>
<u>MM Neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</u>			
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Pagesa për Bletja e aktiveve afatgjata	12	-29.368.369	-3.917.466
Arkëtime nga shitja/uxjerrja Jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale	12	1.816.499	
		<u>-27,551,870</u>	<u>-3,917,466</u>
<u>MM neto, e përdorur në aktivitetet investuese</u>			
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Rritej/ pakësim Detyrimet Te drejta -Ortakët		-	-
Rritje/Pakësime detyrimeve të Huave Bankare	19	-10.132.581	-10.184.878
Rritje/pakësime Qira Financiare	20	3.957.415	-1.444.944
Rritje.pakësime Investime te tjera Financiare	11	-26.077.733	
		<u>-32,252,898</u>	<u>-11,629,822</u>
<u>MM neto e përdorur në aktivitetet financiare</u>			
Diferenca Konvertimi te MM te mbajtura ne Monedhe te Huaj		=	=
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		<u>892,201</u>	<u>1,038,159</u>
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		<u>3,213,937</u>	<u>2,175,780</u>
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		<u>4,106,139</u>	<u>3,213,937</u>

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-31



“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit aksionar për periudhën Janar - Dhjetor 2016

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Fitimi i Pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	420,000,000	7,780,804	74,269,780	502,050,584
Emetim i kapitalit aksionar	80,000,000	-5,730,220	-74,269,780	5,730,220
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël	-	-	100,253,171	100,253,171
Dividendë te Paguar	-	-	-	-
Rritje e Rezervës së Kapitalit	-	-5,730,220	-	-5,730,220
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	500,000,000	2,050,584	100,253,170	602,303,754
Emetim i kapitalit aksionar	100,000,000	253,170	-100,253,170	-253,170
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël	-	-	148,959,464	148,959,464
Dividendë te Paguar	-	-	-	-
Rritje e Rezervës së Kapitalit	-	253,170	-	253,170
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	600,000,000	2,303,754	148,959,464	751,263,218

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-31



“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUJDHËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEJË, PËRNDRYSHË SHKRUHET

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria BILLA&Co sh.p.k, në vijim e quajtur “Shoqëria”, është themeluar sipas aktit të themelimit më datën 07/06/2007 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Billa&Co sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Kapitali është ndare në 4 pjesë me vlerën nominale totale prej 600,000,000 lekë. Në datën e këtyre PF struktura e zotërimit të kapitalit paraqitet si vijon:

Emri i ortakut	Numri i pjeseve	% e kapitalit	Vlera e kapitalit në ALL
Shefqet Billa	1	45.01%	270,060,000
Ideal Billa	1	18.33%	109,980,000
Jetmir Billa	1	18.33%	109,980,000
Arif Billa	1	18.33%	109,980,000
		100.00%	600,000,000

Aktivitet kryesor i shoqërisë, është: Tregti, import – eksport dhe shitje me shumicë e pakice të mallrave, pllaka, hidrosanitare e materiale ndërtimi.

Administratori ligjor i shoqërisë është z. Jetmir Billa.

Adresa e Shoqërisë është : Autostrada Tirane –Durrës, pranë ish Radiostacionit, Kashar Katund i Ri, Tirane

Më 31 Dhjetor 2016 shoqëria ka 58 punonjës (31 Dhjetor 2015 46 punonjës).

Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tiranës me NIPT K62007019T

Gjate vitit 2016 shoqëria ka kryer aktivitetin në përputhje me objektin e saj.

2. Parimet e përgatitjes së pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabël

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit 1-14 (SKK) të përmirësuara të shpallura me urdhrin e Ministrit të Financave nr 64 dt 22.07.2014 Për shpalljen e detyrueshme të tyre.

(b) Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike.

Politikat kontabël janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK-ve të përmirësuara dhe të ligjit nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe paraqiten në shënimin vijues.

3. Politikat kontabël kryesore

Një përmbledhje të pjesës më të madhe të politikave kontabël mbi bazën e të cilave janë përgatitur pasqyrat financiare janë paraqitur sa më poshtë:



“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

3.1 Transaksionet me monedhat e huaja

a. Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

i) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia (“monedha funksionale”). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

ii) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin “Të tjera të ardhura/shpenzime” për diferencat e lidhura me kërkesat për t’u arkëtuar dhe detyrimet ndaj furnitorëve, dhe në zërin “Fitime/humbje nga këmbimi” në rastin e mjeteve monetare.

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2016 janë:

Data / Monedha	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Euro	135.23	137.28
USD	128.17	125.79

3.2 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë MM në dore dhe ato të mbajtura në banka. Në përputhje me SKK 7 “Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare”, Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshijnë MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak).

Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshijnë investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollat e këmbimit, etj). Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korrespondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

3.3 Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogaritë e Arkëtueshme nga Klientët dhe në Kërkesa të tjera të Arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes



“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUIHET

3.3 Aktivet financiare-vazhdim

fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi nëse ka. Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj.

Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa. Huat e dhëna klasifikohen si aktive financiare afatshkurtra, me përjashtim në rast se huamarrësi ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e huas për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël

Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient apo debitor dhe kur një Llogari e Arkëtueshme vlerësohet që nuk mund të arkëtohet, ajo regjistrohet në shpenzimet dhe në Llogarinë e kërkesave të Arkëtueshme. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë çregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma. Shuma e zhvlerësimit është diferenca midis vlerës neto kontabël të aktivitetit dhe vlerës neto aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara, të diskontuara me normën e interesit efektive. Shoqëria nuk ka llogaritur zhvlerësim të klientëve për vitin raportues.

3.4 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 “Inventarët”, kur shoqëria i kontrollon apo i zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti). Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja matet me metodën e mesatares se ponderuar. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuar të shitjes. Sipas gjykimit të drejtimit kostoja është vlera më e vogël dhe prandaj inventarët janë vlerësuar në bilanc me koston e tyre.

3.5 Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

(i) Njohja dhe vlerësimi

AAM vlerësohen në hyrje me kosto historike. AAM paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar minus zhvlerësimin nga ulja e vlerës (nëse ka). Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivitetit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundur që ky element të sjellë hyrje të



“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

3.5 Aktivët Afatgjata Materiale (AAM) - Vazhdim

përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative.

(ii) Amortizimi

Amortizimi i AAM llogaritet dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e vlerës së mbetur me norma të cilat janë të përafërta me jetëgjatësinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e amortizimit të përdorura në ndërtimin e PF për AAM në kontroll të shoqërisë për vitin 2016 janë të paraqitura si me poshtë:

	<i>Norma Amortizimit %</i>	<i>Metoda Llogaritjes</i>
Ndërtime	5%	Me vlerën e mbetur
Instalime, Makineri e pajisje	20%	Me vlerën e mbetur
Mjete Transporti	20%	Me vlerën e mbetur
Mobilje dhe Orendi	20%	Me vlerën e mbetur
Pajisje informatike	25%	Me vlerën e mbetur

3.6 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqëria zbaton politikat e shtytjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave edhe shpenzimet e parapaguara.

3.7 Detyrimet

Shoqëria i klasifikon detyrimet në afatshkurtra dhe afatgjata. Detyrimet afatshkurtra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe në detyrime të tjera

Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë.

Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël. Detyrimet afatgjata vlerësohen në hyrje me koston dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë aktivitetin kryesor të shoqërisë, neto nga TVSH. Ato njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rrezikjet e



“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet -vazhdim

përfitimet e pronësisë së produktit/shërbimit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga mallrat e shitura apo shërbimet e kryera njihen kur ka përfunduar procesi i shitjes apo janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë fatuar, arkëtuar ose jo.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë fatuar apo paguar ato.

3.9 Përfitimet e personelit

(i) Kontributet për sigurime shoqërore dhe te ngjashme

Shoqëria, gjate aktivitetit te saj normal, kryen pagesa ne emër te saj dhe te punonjësve te saj për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ne pajtim me legjislacionin ne fuqi. Kostot përkatëse te bëra ne emër te Shoqërisë ngarkohen ne pasqyrën e te ardhurave me ndodhjen e tyre.

(ii) Pagat e punonjësve

Për punën e kryer nga punonjësit shoqëria njih shpenzimet për pagat e punonjësve. Njohja e shpenzimeve për pagat kryhet kur shërbimi prej punonjësve është përfituar nga shoqëria. Llogaritja e shumës së shpenzimeve të pagave bëhet bazuar në punën e kryer, tarifatat orare dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

3.10 Provizionet

Provizioni njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual qe ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e te cilit pritët te shoqërohet me dalje te burimeve dhe mund te behet një vlerësim relativisht i sakte i shumës se detyrimit. Në periudhën raportuese shoqëria nuk ka llogaritur provizione.

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shoqëria zbaton kërkesat e SKK 11 për tatimin aktual mbi fitimin dhe tatimin e shtyrë mbi fitimin. Shoqëria për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël.

Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korigjuar atë me shpenzimet e panjohura sipas përcaktimit të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. Gjatë vitit 2016 nuk kanë rezultuar diferenca të përkohshme dhe shoqëria nuk ka njohur dhe pasqyruar tatime të shtyra mbi fitimin

Menaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon ti paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

4. Mjetet monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë. Konvertimi i gjendjes në monedhë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2016 të shpallur nga Banka e Shqipërisë, Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në monedhë të huaj janë sistemuar në rezultat. Gjendja e mjeteve monetare dhe te ngjashme në fund të periudhës 2016 paraqitet si vijon:

“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

4. Mjetet monetare - vazhdim

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Mjete monetare në banke	3.793.728	1.915.906
Mjete monetare në arkë	312.412	1.298.031
Total	4,106,139	3,213,937

Një paraqitje e shumave të vendosura në institucionet financiare jepet ne vijim:

Mjete Monetare pranë bankave

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Vendosje ne lek	2.067.700	77.629
Llogari Rrjedhëse pranë Bankave	2.067.700	77.629
Depozita pranë Bankave	-	-
Vendosje ne Monedhe te huaj	1.726.028	1.838.277
Llogari Rrjedhëse pranë Bankave	1.726.028	1.838.277
Depozita pranë Bankave	-	-
Total	3,793,728	1,915,906

Mjete Monetare ne monedhe te huaj pranë bankave

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Llogari Rrjedhëse pranë Bankave	191.034	1.115.675
Llogari Rrjedhëse pranë Bankave	1.534.994	376.112
Llogari Rrjedhëse pranë Bankave	-	346.491
Total	1,726,028	1,838,277

5. Kërkesa të arkëtueshme

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientëve gjendje të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2016. Ato paraqiten me vlerën neto nga zhvlerësimi nga borxhi i keq. Shoqëria nuk ka llogaritur borxh të keq për vitin 2016. Një paraqitje e përbërjes së kërkesave të arkëtueshme ndaj klientëve jepet në tabelën vijuese:

Përshkrimi i Llogarive	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Klientë për shërbime, mallra dhe produkte	128.900.196	87.748.264
Total	128,900,196	87,748,264

Dinamika e të drejtave ndaj klientëve paraqitet si vijon:

Përshkrimi	2016	2015
Gjendja 01 Janar	87,748,264	38,850,913
Rritjet Gjate periudhës ushtrimore	1.620.414.908	1.279.306.151
Pakësimet gjate periudhës ushtrimore	-1.579.262.976	-1.230.408.800
Rritje/(pakësimet) Diferencat e këmbimit	-	-
Gjendja 31 Dhjetor	128,900,196	87,748,264

6. Kërkesa të arkëtueshme të tjera

Në këtë zë të bilancit paraqiten kërkesat e shoqërisë ndaj të tretëve që nuk lidhen me shitjen e shërbimeve dhe të mallrave. Një paraqitje e detajuar e këtij zëri jepet në tabelën vijuese:



“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUËSE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

6. Kërkesa të arkëtueshme të tjera - vazhdim

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Shteti - TVSH për tu marrë	61.989.189	23,021,005
TVSH ne pritje - leasing	940.028	-
Te tjera te drejta ndaj punonjësve	652.890	-
Te tjera te drejta ndaj doganes	53.125	-
Total	63,635,232	23,021,005

7. Instrumente te tjera borxhi

Paraqesin të drejtat që ka shoqëria ndaj të tretëve për parapagimet, interesat e arkëtueshme per kredite e dhena, etj. Përbërja e tyre paraqitet si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Parapagime ne dogane		168.085
Interesa për t'u arkëtuar	3.401.137	1.454.947
Debitorë te tjere	-	4.200
Total	3,401,137	1,627,232

8. Investime të tjera financiare

Paraqet huatë e dhëna nga shoqëria gjatë vitit 2016. Përbërja e tyre paraqitet si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Hua te tretëve	-	26,077,733
Total	-	26,077,733

Në vitin 2016 kjo hua është klasifikuar si hua afatgjatë. Shiko shënimin 11

9. Inventarët

Shoqëria përdor disa lloje mallrash që tregton të nevojshëm për aktivitetin e vet që janë pllakat dhe mallrat hidrosanitare. Ajo përdor metodën e inventarizimit të vazhduar për evidentimin në kontabilitet të gjendjes dhe lëvizjes të inventarëve. Inventarët janë vlerësuar me kosto e cila është konsideruar nga drejtimi i shoqërisë si me e vogla e krahasuar me vlerën neto të realizueshme. Metoda e koston se përdorur është metoda e mesatares se ponderuar. Inventarët paraqiten si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Lëndë të para e materiale të tjera	929.700	218.096
Mallra për rishitje	695.410.323	546.036.106
Parapagesat për furnizime	11.586.850	22.102.637
Total	707,926,872	568,356,839

Në zërin e mallrave për rishitje paraqiten mallrat dhe produktet, te cilat janë importuar dhe janë të gatshme për tu shitur tek klienti. Ato janë të vlerësuar me tërësinë e shpenzimeve të kryera nga shoqëria për t'i patur gjendje gati për shitje ne vendin e ushtrimit te aktivitetit. Parapagesat për furnizime paraqesin pagesat e bëra për blerjen e mallrave që ende nuk kanë mbërritur pranë shoqërisë.



“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

10. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Paraqesin shumat e shpenzimeve të kryera per riparime dhe mirembatje dhe që do të shpërndahen në periudhat e ardhme. Një paraqitje analitike e këtyre shpenzimeve jepet ne tabelën me poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Shpenzime te për tu shpërndare	3,701,524	333,706
Total	3,701,524	333,706

11. Tituj te tjerë te huadhënies

Paraqet huat e dhëna nga shoqëria gjatë vitit 2016. Përbërja e tyre paraqitet si vijon:

Përshkrimi I Llogarive	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Hua te tretëve afatgjata	26.077.733	-
Total	26,077,733	-

Në vitin 2016 kjo hua është klasifikuar nga hua afatshkurter në afatgjatë. Shiko shënimin 8.

12. Aktivet Afatgjata

Gjendja dhe shtesat e pakësimit e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe e amortizimeve të tyre gjatë vitit 2016 paraqiten si në tabelën vijuese:

Pasqyra e ndryshimit të AAM	Toka	Ndertime	Instalime, makineri e pajisje	Pajisje zyre e informatike	Te tjera ne shfrytezim (mobileri, pajisje, etj.)	Aktive afatgjata materiale ne proces	Total
Gjendja 31 Dhjetor 2014	84,000,000	102,483,536	30,204,584	2,108,611	3,114,141	-	221,910,872
Blerjet gjatë viti ushtrimor	-	914,788	225,571	1,509,365	1,267,743	-	3,917,466
Shitjet gjatë viti ushtrimor	-	-	-	-	-	-	-
Pakësime/Shtesa të tjera	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2015	84,000,000	103,398,323	30,430,155	3,617,975	4,381,884	-	225,828,338
Blerjet gjatë viti ushtrimor	-	298,292	6,180,835	480,183	5,767,738	16,641,320	29,368,369
Shitjet gjatë viti ushtrimor	-	-	-	-106,742	-1,792,891	-	-1,899,633
Pakësime/Shtesa të tjera	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2016	84,000,000	103,696,616	36,610,990	3,991,416	8,356,732	16,641,320	253,297,073

Pasqyra e ndryshimit të Amortizimit të AAM materiale

	Toka	Ndertime	Instalime, makineri e pajisje	Pajisje zyre e informatike	Te tjera ne shfrytezim (mobileri, pajisje, etj.)	Aktive afatgjata materiale ne proces	Total
Gjendja 31 Dhjetor 2014	-	10,202,422	10,994,721	1,180,715	622,369	-	23,000,227
Amortizimi i periudhes ushtrimore	-	4,085,048	6,093,583	435,769	592,960	-	11,207,361
Amortizimi i AAGJM te shitura	-	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAGJM te Nxjerra jashte perdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2015	-	14,287,470	17,088,304	1,616,484	-	1,215,329	34,207,588
Amortizimi i periudhes ushtrimore	-	5,617,271	4,046,545	529,610	726,292	-	10,919,718
Amortizimi i AAGJM te shitura	-	-	-	-83,135	-	-	-83,135
Amortizimi i AAGJM te Nxjerra jashte perdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2016	-	19,904,741	21,134,849	2,062,959	1,941,621	-	45,044,171
Vlera neto me 31 Dhjetor 2015	84,000,000	89,110,853	13,341,851	2,001,491	3,166,556	-	191,620,752
Vlera neto me 31 Dhjetor 2016	84,000,000	83,791,874	15,476,141	1,928,456	6,415,111	16,641,320	208,252,902

“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGJESE

SHUMAT NË LEKE, PËRNDRYSHË SHKRUHET

12. Aktivët Afatgjatë - vazhdim

Në bilanc Aktivët Afatgjatë paraqiten për çdo grup me vlerën neto pa amortizimin e akumuluar. Llogaritja e amortizimit të AAM është bërë duke marrë parasysh kohën e hyrjes së AAM. Normat e amortizimit të përdorura (referoju shënimit 3.5 (ii)), janë në përputhje me kërkesat e SKK 4 dhe me ato tatimore për të siguruar një shpërndarje të saktë të kostos së AAM në koston e periudhave që ato përdoren për sigurimin e të ardhurave.

13. Huatë dhe obligacionet afatshkurtra

Paraqet tepriçën e llogarisë së Overdraftet bankare afatshkurtra në Euro dhe ALL që ka marrë shoqëria për plotësimin e nevojave të saj afatshkurtra. Gjendja e overdraftit në euro në fund të vitit 2016 është e konvertuar me kursin e datës së fundit të vitit, dhe diferencat janë kaluar në rezultat. Shuma e këtij zëri paraqitet si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Huat dhe obligacionet afatshkurtra	82.648.503	71.355.718
Total	82,648,503	71,355,718

14. Të pagueshme ndaj furnitorëve

Në këtë zë të bilancit paraqiten detyrimet ndaj furnitorëve ende të papaguara në fund të vitit 2016. Detyrimet ndaj furnitorëve në monedha të huaja janë konvertuar me kursin e datës së fundit të vitit dhe diferencat kanë kaluar në rezultat. Përbërja e këtyre detyrimeve paraqiten si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Furnitorë për mallra, produkte e shërbime	219.279.038	102.185.839
Furnitorë për aktivet afatgjatë	17.834.061	26.034.061
Shpenzime të llogaritura	192.970	247.843
Total	237,306,069	128,467,743

Dinamika e detyrimeve ndaj furnitorëve paraqitet si vijon:

Përshkrimi	2016	2015
Gjendja më 01 Janar	128,467,743	126,850,818
Rritjet gjate periudhës ushtrimore	1.328.536.959	954.754.085
Pakësimet gjate periudhës ushtrimore	-1.219.698.633	-953.137.160
Gjendja më 31 Dhjetor	237,306,069	128,467,743

15. Të pagueshme ndaj punonjësve

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet ndaj punonjësve për pagat e mbetura të papaguara në muajin dhjetor dhe që janë paguar në vitin 2017.

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Detyrime për paga punonjësit	3.849.593	3.116.400
Paga e shpërblime në ruajtje	3.654.612	3.569.612
Total	7,504,205	6,686,012

16. Detyrimet tatimore

Në këtë paraqiten detyrimet ndaj shtetit për Tatimet e taksat si dhe detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore gjendje të papaguara më 31 dhjetor 2016 dhe që janë paguar në vitin 2017. Një paraqitje e përbërjes së këtij zëri jepet në tabelën vijuese:



“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEKE, PËRNDRYSHË SHKRUHET

16. Detyrimet tatimore - vazhdim

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Shteti Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore	821.544	1.382.456
Shteti Tatim Mbi te Ardhurat Personale	630.139	967.597
Tatimi ne burim	178.382	-1.033.108
Tatimi mbi fitimin	6.790.164	3.932.512
Total	8,420,229	5,249,457

17. Hua të tjera

Në këtë zë paraqiten huat e marra në leke një individ për të mbuluar nevojat përkohshme për mjete monetare të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë. Shoqëria ka zvogeluar kete detyrim ne raport me vitin 2015.

18. Parapagime e arkëtuara

Paraqesin shumat e arkëtuara paraprakisht nga klientët për furnizimet qe do ju bëhen atyre në vitin e ardhshëm.

19. Huat bankare

Paraqet gjendjen e luas bankare afatgjata të marra nga shoqëria për 294 600 Euro tek RZB. Ky detyrim është konvertuar me kursin e datës së fundit të vitit.

20. Qera Financiare

Paraqet detyrimin ndaj Raiffeisen Leasing për blerjen me qira financiare të 4 mjeteve të saj. Informacioni për këtë detyrim paraqitet si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Qera Financiare Raiffeisen Leasing	8,921.884	4.964.469
Total	8,921,884	4,964,469

21. Kapitallet e veta

Gjendja e kapitaleve të veta më 31 dhjetor 2016, sipas zërave kryesorë të tyre të paraqitura në bilancin kontabël paraqitet si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Kapitali i paguar	600.000.000	500.000.000
Rezerva ligjore	2.303.754	2.050,584
Fitimi (Humbja) i e vitit te kaluar	-	-
Fitimi (Humbja) i/e vitit financiar	148.959.464	100.253.171
Total	751,263,218	602,303,755

Shoqëria ka rritur kapitalin e paguar të saj në vitin 2016 duke kapitalizuar fitimin e vitit 2015.



“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

22. Të ardhurat

Shoqëria i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës. Shoqëria realizon të ardhurat nga aktiviteti i saj që është tregtimi i artikujve të ndryshëm si pllaka, materiale hidrosanitare, etj..

22. Të ardhurat - vazhdim

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Te ardhura nga shitja e mallrave	1,370,482,732	1,038,439,215
Total	1,370,482,732	1,038,439,215

23. Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Përbëjnë të ardhurat që kanë ardhur nga shitja e shërbimeve dhe punimeve si dhe nga zbritjet e bëra nga furnitorët. Informacioni për to paraqitet si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Shitje e punimeve dhe e shërbimeve	208.649	13,660,206
Te ardhura te tjera	26.957.240	17,337.579
Total	27,165,889	30,997,786

Të ardhurat e tjera përbëhen nga të ardhurat nga komisionet, nga transporti, nga shitja e AAM, nga credit note të furnitorëve, të ardhura të tjera, etj.

24. Materiale te konsumuara (KMSH)

Në këtë zë përfshihen kostoja e mallrave dhe shërbimeve te shitura gjate vitit ushtrimor. Sic u përmend edhe me sipër shoqëria përdor metodën kontabël të inventarizimit te vazhduar. Përmbajtja paraqitet si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Blerje /shpenzime mallra, shërbimesh	1.070.051.801	843.329.726
Total	1,070,051,801	843,329,726

25. Shpenzime personeli

Në shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura gjatë vitit 2016. Gjatë kësaj periudhe raportuese shoqëria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar në përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit. Përbërja e shpenzimeve të pagave paraqitet si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Shpenzime për paga	52.773.508	38.666.420
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore	5.347.595	3.576.435
Total	58,121,103	42,242,315



“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUËSE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

Në nënzërin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore paraqiten shuma e kontributeve që llogarit dhe paguan shoqëria mbi fondin e pagave të punonjësve. Kontributet janë llogaritur në përputhje me tarifat dhe mënyrën e parashikuar nga ligji i kontributeve shoqërore e shëndetësore.

26. Shpenzimet e tjera

Përbërja e këtij zëri të shpenzimeve paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Qira	10.907.843	11.271.334
Shpenzime materiale te ndryshme. energji, etj	13.812.319	12.594.222
Transferime, udhëtime, dieta, etj	3.624.473	5.911.881
Shpenzime komisione bankare	2.043.956	1.500.110
Shpenzime konsulence. shërbime nga të tretët dhe te tjera profesionale	4.395.400	2.364.525
Shpenzime mirëmbajtje	6.378.380	5.184.758
Shpenzime telefoni, internet, dhe te ngjashme	465.306	684.699
Transporte për shitje	570.767	466.216
Shpenzime Publicitet, reklama, marketing	15.900.975	2.768.172
Shpenzime për taksat	2.699.370	1.373.755
Gjoha dhe dëmshpërblime	1.588.865	21.877
Te tjera	18.464.341	7.446.590
Total	80,851,996	51,588,139

Shpenzimet e qerasë paraqesin qeranë e dyqaneve ku ushtron aktivitet shoqëria.

Shpenzime materiale te ndryshme, energji, përbëhen kryesisht nga shpenzimet e karburanit, energjisë elektrike, etj.

Shpenzimet e konsulencës dhe nga të tretët paraqesin kostot e shërbimeve ligjore, fiskale, noteriale, etj.

Shpenzimet për mirëmbajtje e riparime paraqesin shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e kapanonit, të ambienteve të tjera, te mjeteve të shoqërisë, etj.

Shpenzimet e tjera, paraqesin pagesat shpenzime pritje e përfaqësimi, shpenzime dogane, blerje te ndryshme te tjera, etj.

27. Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata

Paraqet te ardhurat nga interesat për huat e dhëna. Përbërja e këtij zëri paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Te Ardhura nga Interesi	1.955.832	651.206
Total	1,955,832	651,206

28. Shpenzime financiare

Përbërja e tyre paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Shpenzime nga Interesi huaje	7.471.407	9.633.577
Shpenzime për Interesa Qira financiare	524.285	417.754
Total	7,995,693	10,051,331



“BILLA&CO” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PËRFUNDOI ME
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUËSE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

29. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi

Paraqesin fitimet dhe humbjet e vërtetuara gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve dhe të të drejtave e detyrimeve të shprehura në monedhë të huaj.

Paraqitja e tyre jepet në tabelën vijuese:

29. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi - vazhdim

Përshkrimi	31 Dhjetor 16	31 Dhjetor 15
Fitimi nga Kurset e këmbimit	6.389,762	12,977,654
Humbje nga Kurset e këmbimit	(2.114.276)	(6.315.636)
Total	4,275,485	6,662,019

30. Tatimi aktual

Shoqëria ka rezultuar me një fitim kontabël 175,939 mijë leke. Për llogaritjen e rezultatit tatimor të vitit 2016 shoqëria ka bërë rregullimet e nevojshme fiskale, duke konsideruar si të panjohura për qëllime fiskale një sërë shpenzimesh. Fitimi fiskal i shoqërisë për vitin 2016 rezulton 179,867 mijë lekë.

Llogaritja e shpenzimeve të panjohura, dhe e rezultatit fiskal për gjithë vitin 2016 paraqiten si në tabelën vijuese:

Pasqyra e rezultatit tatimor 2016	Viti 2016	Viti 2015
Fitimi/Humbja e vitit	175,939.628	118.331.353
Korrigjimet e rezultatit sipas ligjit tatimor:	3,928,135	2,189,866
Shpenzime të panjohura fiskalisht		
<i>Shpenzime të tjera</i>	-	2.167.989
<i>Gjaba Penalitete e te ngjashme</i>	3,928.135	21.877
Totali i shpenzimeve të panjohura	3,928,135	2,189,866
Fitimi/Humbja i tatueshëm para mbartjes së humbjes fiskale	179,867,763	120,521,219
Humbja fiskale nga viti	-	-
Fitimi/Humbja fiskale e vitit	179,867.763	120,521,219
Norma e tatimit aktual mbi fitimin	15%	15%
Tatimi aktual mbi fitimin	26,980.164	18,078.183
Shpenzimi kontabël i tatimit mbi fitimin	26,980,164	18,078,183

Shoqëria përdor norma amortizimi sa normat tatimore (referoju shënimit 3.5 (ii)).

31. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme që të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.

